



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Prishtinë, 16 nëntor 2022**  
**Kodi i ZRRE-së V\_1617\_2022**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Dispozitat e Nenit 9, Nenin 16, Nenin 25, Nenin 26, Nenin 55 par. 1, nënpar.1.1, 1.2 dhe 1.5, Nenin 56 par. 1 nënpar. 1.2, dhe Nenin 57 par. 2 nënpar. 2.2, 2.8, 2.11 dhe 2.14 lidhur me par. 3, par. 6, 7, 8 dhe 9 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Dispozitat e Nenit 28 par. 1 nënpar. 1.3, 1.17 dhe 1.21 të Ligjit për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085;
- Dispozitat e Nenit 9 të Procedurës për Tregtimin e Energjisë Elektrike;
- Dispozitat e Nenit 11.1.9 të Rregullave të Tregut;
- Dispozitat e Nenit 2.5.1.2 të Kodit të Balancit;
- Dispozitat e Nenit 3, Nenin 4, Nenit 5, Nenin 7 dhe Nenin 8 dhe Nenin 9 par. 2 nënpar. 1.2, 1.8, 1.11 dhe 1.14 lidhur me par. 2, par. 4, 6, 7, 10, 12 dhe 13 të Rregullës Nr. 06/2017 për Masat Administrative dhe Gjobat;
- Dispozitat e Nenit 3, Nenit 9 par. 2, Nenit 23 dhe Nenit 32 të Licencës për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes Nr. ZRRE/Tr\_06/17 për "KEDS" SH.A.;
- Njoftimin e ZRRE-së, Nr. 448/22 të datës 14 tetor 2022 lidhur me shkeljet e konstatuara për blerjet e energjisë elektrike, pagesat dhe nominimet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes („KEDS” SH.A.); dhe
- Përgjigjet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (“KEDS” SH.A.) të pranuar me datë 28.10.2022 Nr. prot. 1106/2022,

**në seancën e mbajtur me 16 nëntor 2022 ka nxjerr këtë:**

## **V E N D I M**

- I. I SHQIPTOHET - DENIMI ME GJOBË** Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes („KEDS” SH.A), për shkak të shkeljeve ligjore të konstatuara për blerjet e energjisë elektrike, pagesat dhe nominimet në shumën prej **2,753,000€ (dy milion e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë Euro)**.
- II. DETYROHET** - Operatori i Sistemit të Shpërndarjes („KEDS” SH.A), që brenda periudhës 2 (dy) vjeçare në 4 (katër) këste, të paguajë gjobën në llogarinë Nr. 1000 4300 7000 8375 në Buxhetin e Republikës së Kosovës, në shumën e përcaktuar si në pikën I. të dispozitivit, nën pasojat e përmbartimit me detyrim.

## **A R S Y E T I M**

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në përputhje me kompetencat e dhëna me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, ka bërë monitorimin në lidhje me blerjet e energjisë elektrike, pagesat dhe nominimet për Operatori i Sistemit të Shpërndarjes („KEDS” SH.A).



Monitorimi ishte fokusuar në mbledhjen, vlerësimin dhe analizimin e të dhënave dhe të pajtueshmërisë në të gjithë aspektet materiale, aktivitetet ekonomike dhe financiare, transaksionet dhe informacionet janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe kornizën rregullative në fuqi.

Qëllim ishte që të vërtetohen shkeljet eventuale në lidhje me evidentimin e devijimeve nga parimet e ligjshmërisë, mbi: a) Faturimin dhe Pagesat ndërmjet të Licencuarve; b) Blerjet e importit nga FSHU dhe Procesin e shitjes së energjisë nga Importi për mbulim të humbjeve tek OSSH (KEDS), si dhe c) Devijimet në nominimin e energjisë së KEDS për humbje.

ZRRE, në kuadër të monitorimit në lidhje me blerjet e energjisë elektrike pagesat dhe nominimet për Operatori i Sistemit të Shpërndarjes („KEDS” SH.A) ka përgatitur një Raport me të gjeturat të cilin ja ka prezantuar Bordit të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së, në mbledhjen e mbajtur më datë 24.06.2022, ka shqyrtuar të gjeturat në Raportin e përgatitur nga ekspertët e ZRRE-së, dhe më datë 24.06.2022, përmes dokumentit Raporti i Monitorimit në lidhje me blerjet e energjisë elektrike pagesat dhe nominimet për operatorin e sistemit të shpërndarjes (KEDS) dhe furnizuesin me energji elektrike („KESCO” SH.A), ka njoftuar palët lidhur me të gjeturat e Monitorimit. Po ashtu, Bordi i ZRRE-së, bazuar në Nenin 7 par. 2 të Rregullës Nr. 06/2017 për Masat Administrative dhe Gjobat, ka kërkuar nga “KEDS” SH.A. që në afat prej 15 ditë kalendarike të ofroj përgjigjet me shkrim lidhur me të gjeturat në Raport.

ZRRE me datë 08.07.2022 nga „KEDS” SH.A, ka pranuar Komentet në Raportet e Monitorimit për blerjet e energjisë elektrike, pagesat dhe nominimet për Operatori i Sistemit të Shpërndarjes („KEDS” SH.A) të datës 24.06.2022, duke paraqitur përgjigjet në të gjeturat dhe konstatimet e evidentuara nga Raporti i Monitorimit të ZRRE-së.

ZRRE ka vlerësuar komentet e dërguara nga „KEDS” SH.A., lidhur me monitorimin e blerjeve të energjisë elektrike, pagesat dhe devijimet në nominimet e energjisë nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes “KEDS” SH.A.

ZRRE ka vlerësuar se, sa i përket pjesës së shthurjes operative dhe ligjore, në të cilën thirret „KEDS” SH.A, dhe vazhdimin e prokurimit të energjisë për palët edhe për një kohë, ZRRE ka vlerësuar se komenti i palës ka të bëjë me problemet financiare me shfaqjen e pandemisë COVID 19 e më vonë krizës energjetike, por monitorimi konteston mënyrën e kryerjes së shërbimit për prokurimin e humbjeve nga “KEDS” SH.A.

ZRRE konsideron se nuk janë relevante sqarimet e dhëna nga “KEDS” SH.A, lidhur me pretendimet e ZRRE-së, për prokurimin e energjisë elektrike të shprehura në raportin e monitorimit, prandaj rikujton KEDS-in se nuk ka prokuruar energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve siç parashihet me dispozita ligjore, respektivisht Paragrafin 1.21 të Nenit 28 të Ligji Nr 05/L-085 për Energjinë Elektrike si dhe Nenit 9 të Procedurës për Tregtimin e Energjisë.

ZRRE po ashtu rithekson se gjatë periudhës së monitorimit, OSSH nuk ka ushtruar përgjegjësitë të dhëna me legjislacion i cili obligon KEDS/OSSH-në, të siguroj energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe për shërbimet ndihmëse, sipas parimeve të tregut të energjisë elektrike, transparencës dhe jo diskriminimit.

Sa i përket çështjes së devijimeve për të cilat „KEDS” SH.A ka pretenduar, komentet e arsyetimet e tilla nuk qëndrojnë, për faktin se ZRRE konsideron se devijimet e shkaktuara në dhjetor 2021 në ditët



specifike sillej nga -33% deri 75% për „KEDS” SH.A e në një ditë specifike ishte 99%. Pra „KEDS” SH.A ka nominuar vetëm sasinë e energjisë që kishte “KEK” SH.A. në dispozicion dhe nuk kanë tentuar të importojnë energji për këtë periudhë. Për më tepër, „KEDS” SH.A nuk kishin ndonjë konfirmim nga ZRRE lidhur me kërkesën e tyre për mbështetje vetëm në prodhimin vendor, si dhe për mos-përgjegjësi për devijimet e shkaktuara, prandaj ZRRE konfirmon, se nuk janë relevante sqarimet e dhëna dhe se KEDS nuk ka vepruar sipas Nenit 11.1.9 të Rregullave të Tregut dhe Nenit 2.5.1.2 të Kodit të Balancit.

Bordi i ZRRE-së, në mbledhjen e mbajtur me datë 12.10.2022 pas shqyrtimit të përgjigjeve/komenteve të dërguara nga „KEDS” SH.A, ndaj Raporti i Monitorimit për në lidhje me blerjet e energjisë elektrike, pagesat dhe nominimet për Operatori i Sistemit të Shpërndarjes („KEDS” SH.A), ka konstatuar se: i) „KEDS” SH.A. nuk ka prokuruar energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve siç parashihet me dispozita ligjore, respektivisht paragrafin 1.21 të Nenit 28 të Ligji Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike si dhe Nenit 9 të Procedurës për Tregtimin e Energjisë; ii) KEDS nuk ka ushtruar përgjegjësitë të dhëna me këtë legjislacion i cili obligon OSSH-në, të siguroj energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe për shërbimet ndihmëse, sipas parimeve të tregut të energjisë elektrike, transparencës dhe jo diskriminimit; iii) „KEDS” SH.A ka nominuar sasi më të vogla të energjisë për humbje e rrjetit të shpërndarjes se sa vet parashikimi i tij. Dështimi i KEDS-it për të nominuar energjinë elektrike për të mbuluar humbjet në shpërndarje ka rritur shkallën e devijimeve në nivelin e interkonkesionit, duke shkaktuar pasoja financiare; dhe iv) „KEDS” SH.A nuk ka vepruar sipas Nenit 28 paragrafit 1.3 dhe 1.17 të Ligjit për Energjinë Elektrike, Nenit 11.1.9 të Rregullave të Tregut, Nenit 2.5.1.2 të Kodit të Balancit dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes lëshuar nga ZRRE.

Bordi i ZRRE-së, bazuar në ato më lartë ka vërtetuar se në asnjë rast dhe me asnjë fakt qoftë formal apo material KEDS sh.a., nuk ka mundur të kundërshtoi/argumentoj të gjeturat përmes Raportit të Monitorimit lidhur me blerjet e energjisë elektrike, pagesat dhe nominimet për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes KEDS, andaj ka nxjerr Njoftim lidhur me shkeljet e konstatuara për blerjet e energjisë elektrike, pagesat dhe nominimet nga Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (“KEDS” SH.A.).

ZRRE në përputhje me dispozitat e Nenit 57 paragrafi 7 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Njoftimi i cekur më lartë i është dërguar me datë 14.10.2022 “KEDS” SH.A. në mënyrë që tu mundësohet përgjigja me shkrim lidhur me shkeljet e bëra, brenda katërmëdhjetë (14) ditësh nga pranimi i këtij njoftimi.

ZRRE me datë 31.10. 2022 nga “KEDS” SH.A. ka pranuar përgjigjet me shkrim, në lidhje me shkeljet e konstatuara me Njoftimin e cekur më lartë, ku janë paraqitur në formë të shkruar arsyetimet në lidhje me shkeljet e konstatuara nga ZRRE, si dhe arsyetime tjera jashtë atyre të konstatuara përmes Njoftimit të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE, në mbledhjen e mbajtur me datë 16.11.2022, ka bërë vlerësimin dhe analizimin e përgjigjeve të paraqitura nga „KEDS” SH.A, dhe ka ardhur në përfundim se përgjigjet e “KEDS” SH.A., nuk i kontestojnë me asnjë argument qoftë formal apo material shkeljet e evidentuara nga ana e ZRRE-së, por i njëjti duke dashur t’u shmanget përgjegjësi dhe shkeljeve të konstatuara është thirrur në atë se cilat janë obligimet e „KEDS” SH.A, duke u thirrur në atë, se mos-reflektimi i saktë i kostove dhe çmimeve nga ZRRE gjatë procesit të rregulltarit ka pasur ndikim tek ajo, si dhe është thirrur në atë



se si rezultat e vendimeve të vonuara dhe mungesës së reagimit në kohë nga ana e institucioneve përgjegjëse për sektorin e energjisë, janë shkaktuar pasoja për kompaninë.

ZRRE, vlerëson edhe njëherë, se pretendimet e „KEDS” SH.A, lidhur me mos-reagimin me kohë nuk qëndrojnë, për faktin e pamohueshëm se, ZRRE gjatë shqyrtimit të rregullt tarifor në muajin tetor të vitit 2021, kishte reflektuar të gjitha kostot e sistemit për Operatorin e sistemit të shpërndarjes „KEDS” SH.A, në pajtim të plotë me Rregullën për të Hyrat e OSSH-së, dhe njëkohësisht ka theksuar se kurdo që shfaqet nevoja e shqyrtimit të jashtëzakonshëm, ZRRE do të ndërmarr të gjitha veprimet ligjore dhe do ti trajtoj të gjitha kostot e të licencuarave të rregulluar. Prandaj, në dhjetor të vitit 2021 pas plotësimit të kriterëve nga ana e të Licencuarve ka iniciuar Procesin e shqyrtimit të jashtëzakonshëm për reflektimin e kostove edhe për të licencuarin „KEDS” SH.A, të cilit iu kanë njohur të gjitha kostot me vendimin e muajit shkurt 2022 (Vendimi Nr. V\_1485\_2022) që ka përfshirë të gjitha kostot e shkaktuara nga muaji tetor i vitit 2021 e më tej. Prandaj, këto pretendime nga ana e „KEDS” SH.A, nuk qëndrojnë dhe nuk kanë të bëjnë fare me procesin e monitorimit, mirëpo për shkak të vlerësimit dhe eliminimit të çfarëdo paqartësie, i kemi trajtuar me shumë kujdes dhe në përkujdesje të respektimit të legjislacion në fuqi.

Pretendimet tjera të paraqitur nga përgjigjet e „KEDS” SH.A nuk janë relevante dhe nuk ka mundur të bëj të besueshëm për të vepruar ndryshe, për faktin se KEDS ka vepruar në kundërshtim me Licencën dhe obligimet ligjore në lidhje me prokurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve, e për të cilën nuk e ka mohuar me asnjë fakt, prandaj vërtetohet se ka vepruar në kundërshtim me Nenin 28 par. 1.21 të Ligjit për Energji Elektrike.

Po ashtu vërtetohet fakti se „KEDS” SH.A nuk ka ushtruar përgjegjësitë të dhëna me legjislacion i cili obligon OSSH-në, të siguroj energjinë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe për shërbimet ndihmëse, sipas parimeve të tregut të energjisë elektrike, transparencës dhe jo diskriminimit, dhe për pasoj ka rrezikuar furnizimin e rregullt të konsumatorëve me të drejtën e shërbimit universal, kur dihet se operatori i sistemit të shpërndarjes ka një rol vendimtar në ofrimin e shërbimeve dhe furnizimin e rregulluar me energji për të gjithë konsumatorët e rregulluar.

Për sa u përket pretendimeve të „KEDS” SH.A., në lidhje me devijimet, e njëjta përsëri ka bërë një përshkrim të situatës si në përgjigjet në raportin e Monitorimit, duke u thirrur në situata të ndryshme, ku ka theksuar se nuk mund të mbahet përgjegjës për devijimet në nivelin e interkoneksionit, pasi kjo është rezultat i veprimeve dhe vendimeve të vonuara nga institucionet përgjegjëse në sektorin e energjisë, duke u thirrur në situatë të forcës madhore, dhe pretendimet e tilla nuk qëndrojnë, por janë pasoj e mosveprimit duke nominuar sasi më të vogla të energjisë për humbjet e rrjetit të shpërndarjes sesa vet parashikimi i KEDS. Prandaj, dështimi i „KEDS” SH.A., për të nominuar energjinë elektrike për të mbuluar humbjet në shpërndarje ka rritur shkallën e devijimeve të interkoneksionit, duke shkaktuar pasoja financiare.

Vlen të theksohet se edhe përkundër se „KEDS” SH.A. i njihen të gjitha kostot e operimit, si operator i sistemit të shpërndarjes duke i përfshirë edhe humbjet e lejuara, të njohura përmes vendimit për të hyrat maksimale të lejuara dhe gjithashtu i janë reflektuar të gjitha kostot përmes shqyrtimit tarifor, qoftë të rregullt po ashtu edhe të jashtëzakonshëm, prandaj duke dashur të përdor situata analoge dhe të relativizoj obligimet ligjore të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, si i licencuar i rregulluar me



të gjitha kostot e njohura nga ZRRE, mos përgjegjësia e tij në nominime të sakta për nevoja të OSSH-së, bie në shkelje dhe në kundërshtim me Nenit 28 paragrafit 1.3 dhe 1.17 të Ligjit për Energjinë Elektrike, Nenin 11.1.9 të Rregullave të Tregut dhe Nenin 2.5.1.2 të Kodit të Balancës.

Bordi ZRRE-së, me rastin e nxjerrjes së këtij vendimi, ka vlerësuar drejt këtë çështje procedurale në rastin e shqiptimit të gjobës, për faktin se në kuadër të përgjegjësive ZRRE, ka zhvilluar monitorim të bazuar në ligj, Procedurën për Tregtimin e Energjisë dhe Licencën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, Rregullat e Tregut dhe Kodin e Balancës, andaj, për të arritur te gjendja materiale ka vërtetuar drejt gjendjen faktike, dhe pas vërtetimit të drejtë të kësaj çështje në lidhje me veprimet e të Licencuarit, pretendimet e "KEDS" SH.A. janë vlerësuar si të pa bazuara.

Bordi i ZRRE-së, po ashtu ka trajtuar edhe me shumë kujdes edhe çështjet tjera të cekura në përgjigjet e "KEDS" SH.A., të cilat nuk janë relevante, pasi që konstatimet e vërtetuara nga ZRRE në asnjë rast dhe me asnjë fakt nuk ka mundur të kundërshtoi/argumentoj të gjeturat përmes Raportit të Monitorimit, por i njëjti vetëm ka bërë një përshkrim dhe vlerësime, dhe më këtë rast i njëjti ka vepruar në kundërshtim të plotë me obligimet e Licencës dhe obligimin e nxjerra nga Bordi i ZRRE-së, dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së, me rastin e shqiptimit të dënimit me gjobë dhe ndarjen në këste në periudhën 2 (dy) vjeçare, i ka marr parasysh edhe rrethanat lehtësuese duke pasuar parasysh sjellën paraprake, situatën financiare të të licencuarit të ndikuar edhe nga pandemia me COVID 19, si dhe rrethanat që kanë ndikuar nga situata financiare energjetike si dhe veprimet e të licencuarit të përmendura më lartë. ZRRE gjithashtu ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese edhe sjelljen dhe bashkëpunimin e "KEDS" SH.A., me ZRRE-në, gjatë tërë këtij procesi.

Bordi i ZRRE-së, po ashtu me rastin e shqiptimit të gjobës ka vlerësuar edhe rrethanat rënduese, për faktin se qëllimi i këtij dënimi nuk është dëmtimi i ndërmarrjes, por përmirësimi i saj, që në veprimet e ardhshme në të mirë të sigurisë juridike të vetë të Licencuarit që të respektohen kushtet e Licencës dhe kërkesat ligjore të obligueshme në fuqi dhe të zbatueshme.

Bordi i ZRRE-së, për sa i përket shumës së gjobës si në dispozitivin nën pikën I. të këtij Vendimi, ka marr parasysh shkeljet e konstatuara, dhe në mënyrë komulative të të gjitha shkeljeve është propozuar gjoba bazuar në të hyrat që ndërmarrja ka akumuluar gjatë vitit fiskal paraprak, e që janë të bazuara në Raportin e Auditorit të Pavarur për Pasqyrat Financiare për Qëllime Specifike të Rregullatorit për vitin 2021 të KEDS SH.A. dhe të dërguara në ZRRE.

Vendimi mbi shqiptimin e gjobës është marr konform dispozitave ligjore të Nenit 57 paragrafi 2 nënpar. 2.2, 2.8, 2.11 dhe 2.14 lidhur me par. 3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, dhe dispozitat e Nenit 2 nënpar. 1.2 dhe 1.11 dhe 1.14 lidhur me par. 2 dhe 4 të Rregullës Nr. 06/2017 për Masat Administrative dhe Gjobat, të nxjerr nga ZRRE.

Vendimi për pagesën e gjobës është marr konform dispozitave ligjore të Nenit 57 paragrafi 9 i Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.







IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**



Ymer Fejzullahu, Kryesues



Selman Hoti, anëtar



Izet Rushiti, anëtar



Lutfiye Dervishi, anëtar



Gani Buçaj, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Arkivit të ZRRE-së.